

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-200/14

Prishtinë, 18 maj 2016

Në çështjen juridike të:

R. P.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, gjyqtare duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA53166), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 18 maj 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R.P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014, të datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA53166.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014, i datës 13 mars 2014, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA53166.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 26 nëntor 2007, R. P. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), e cila ishte regjistruar me numrin e lëndës KPA53166, ku kërkonte ri-posedimin e shtëpisë me sipërfaqe prej 432 metrash katrorë që ndodhet në Rrugën “Marka Oreškoviča” 57 në Brezanik, Pejë (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Pala ankuese nuk ka përmendur numrin e ngastrës.
2. Me kërkesë pala ankuese ka dorëzuar *inter alia* në AKP:
 - Vendimin nr.436-1/5985 të lëshuar nga Administrata Republikane për të Hyra Publike – Departamenti për Vlerësimin dhe Mbledhjen e të Hyrave Publike – Pejë, mbi përcaktimin e tatimit në pronë për persona fizik, me anë të së cilit për tatimpaguesin R. P. për periudhën 01.01.1996 - 31.12.1996 është përcaktuar një taksë e përgjithshme për objektin rezidencial me sipërfaqe prej 100 metrash katrorë. Prona dhe adresa e saj nuk janë përshkruar në dokument.
 - Kërkesën për lidhje dhe faturat për energjinë e konsumuar elektrike për ndërtesën që ndodhet në Pejë, në Rrugën 67 M. Dreskovic.
3. Dokumentet e sipërpërmendura ishin verifikuar **negativisht** nga AKP-ja.
4. AKP-ja kishte kontaktuar palën ankuese dhe kishte kërkuar dorëzimin e dokumenteve shtesë që dëshmonin të drejtën mbi pronën e kërkuar. Pala ankuese nuk kishte dorëzuar dokumente të tjera.
5. Njoftimi fizik i kërkesës ishte bërë më 29 janar 2008 ndërsa përmes publikimit në gazetën e AKP-së më 25 prill 2013. Ekipi njoftues kishte gjetur se prona e kërkuar është një shtëpi i shkatërruar me oborr dhe nuk është e uzurpuar. Askush nuk kishte marrë pjesë si palë përgjegjëse në kërkesë në procedurë.
6. Më 13 mars 2014, KKPK me vendimin e tij KPCC/D/R/231/2014 kishte refuzuar kërkesat me arsyetimin se pala ankuese nuk e kishte dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar dhe AKP-ja nuk kishte gjetur ex officio asnjë provë mbi të drejta të tilla pronësore.

7. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 23 qershor 2014. Më 30 qershor 2014 pala ankuese kishte paraqitur ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

8. Në ankesën e tij, pala ankuese thekson se është një shtëpi e cila është e regjistruar në emrin e tij në Rrugën “Marka Oreškovič” 57 në Pejë. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që t’i jep atij vendimin e duhur sa më parë që është e mundur.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

9. Ankesa ishte paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh që parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

10. Ndryshe nga siç pretendohet nga pala ankuese, Gjykata Supreme konstaton se pala ankuese nuk ka prezantuar prova të mjaftueshme për vërtetimin e drejtave të kërkuara pronësore. Të gjitha dokumentet e siguruar nga pala ankuese ishin verifikuar negativisht dhe AKP nuk ka mundur të sigurojë ex officio asnjë dokument që do të mbështeste të drejtat e pretenduara pronësore. Pala ankuese edhe pas disa kërkesave nuk ka prezantuar prova të tjera për të mbështetur pretendimet e tij.
11. Rrjedhimisht, KKPK me të drejtë ka refuzuar kërkesën. Nuk kishte pasur as shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
12. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it